

VENDIM
Nr. 8, datë 10.1.2018

MBI MIRATIMIN E LICENCËS “TIP” TË AKTIVITETIT TË TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe neneve 22; 23 dhe 35 të ligjit nr. 102/2015, “Mbi sektorin e gazit natyror”, si dhe nenit 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.1.2018, mbasi shqyrtoi relacionin për miratimin e licencës “tip” të transmetimit të gazit natyror, të përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 153, datë 28.9.2017, ERE ka filluar procedura për miratimin e licencës “tip” të transmetimit të gazit natyror.
- Me shkresën nr. 100/46 prot., datë 2.10.2017, ERE ka vijuar me publikimin në media të njoftimit për fillimin e procedurës për miratimin e licencës “tip” të transmetimit të gazit natyror.
- Me shkresën nr. 166/8 prot., datë 3.10.2017, ERE ka kërkuar komente dhe opinione nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti i Konkurrencës, Albgaaz sh.a., Albpetrol sh.a., edhe pranë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.
- Në përfundim të afatit të marrjes së komenteve dhe opinioneve nga palët rezultoi se mbi këtë draftlicencë janë shprehur Autoriteti i Konkurrencës dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, komentet e të cilëve janë pranuar kryesisht dhe përpunuar nga ERE.
- Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë licencën “tip” të aktivitetit të transmetimit të gazit natyror.
2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.
Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

LICENCË PËR
AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR

Licencë nr.:

Vendimi i ERE-s:

Data efektive:

Lëshuar personit: (Emri i plotë dhe adresa ligjore e personit)

NUIS: _____

Vendimi i ERE-s për certifikimin e subjektit _____

Sipas Autoritetit dhënë Entit Rregullator i Energjisë (ERE) dhe në përputhje me:

- a) Ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe
- b) Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017.
- c) Rregullorja mbi procedurat e heqjes licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror e miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.
- d) Rregullat për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror, miratuar me vendimin e ERE-s nr. 100, datë 5.8.2015, dhe ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 31.10.2015.
- e) Rregulloren për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016.
- f) Rregullat dhe rregulloret që kanë të bëjnë me sektorin e gazit natyror.

Enti Rregullator i Energjisë i jep këtë licencë transmetimi (licencë) për kryerjen e aktivitetit të transmetimit të gazit natyror në territorin e përcaktuar në këtë licencë, personit të sipërpërmendur, këtej e tutje referuar si “i licencuari”, subjekt i kushteve të licencës bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj licence.

Kjo licencë së bashku me kushtet e saj bashkëlidhur është e vlefshme prej datës efektive të sipërshënuar dhe do të ketë efekt për një periudhë 30-vjeçare, në qoftë se licenca nuk hiqet nga ERE në zbatim të nenit 27, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe në përputhje me “Rregulloren për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, si dhe kushtet që përmban kjo licencë.

Autoriteti lëshues (ERE)

Kryetari [selia e ERE-s]

Pranuar prej personit të licencuar së bashku me kushtet e licencës;

I licencuari

Përfaqësuesi zyrtar

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

KUSHTET E LICENCËS PËR
AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR

Vendimi i ERE-s nr.:

Licencë nr.:

Vendimi i ERE-s:

Data efektive:

Licencë lëshuar personit: (Emri i plotë dhe adresa ligjore e personit)

NUIS:

Vendimi i ERE-s për certifikimin e subjektit

PJESA E PARË

Neni 1

Dispozita të përgjithshme

a) Në përputhje me ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, ERE është i vetmi autoritet në Republikën e Shqipërisë që ka të drejtën të lëshojë dhe deklarojë vlefshmërinë e kësaj licence.

b) Nëse bazuar në një vendim me shkrim të ERE-s, ndonjë ose disa prej kushteve të kësaj licence bëhen të pavlefshme, anulohen apo pushojnë së qeni në fuqi, kushti ose kushtet në fjalë duhet të hiqen nga kushtet e licencës, ndërkohë që kushtet e tjera të mbetura të licencës mbeten efektive dhe me fuqi të plotë.

c) Nuk lejohet transferim i të drejtave të licencës apo të aseteve tek asnjë person tjetër, pa aprovimin paraprak me shkrim të ERE-s. Kur aprovon një transferim, ERE mund të modifikojë periudhën e licencimit dhe ndonjë kusht tjetër të licencës, duke treguar arsyen.

d) I licencuari duhet të respektojë ligjet në fuqi, vendimet e qeverisë, rregullat dhe rregulloret, si edhe vendimet e miratuara nga ERE.

e) ERE ka të drejtën ekskluzive për modifikimin e kësaj licence në rastin e ndryshimit të kushteve dhe rrethanave në përputhje me ndryshimet në ligj, vendimet e qeverisë, rregullat dhe rregulloret, si edhe vendimet e miratuara nga ERE.

f) ERE i jep licencë për transmetimin e gazit natyror vetëm një personi juridik, për një territor të caktuar. Përjashtim bëhet vetëm për rastet kur në një territor të caktuar është e domosdoshme të shtrihen dhe të kryejnë veprimtari edhe infrastruktura të transmetimit të gazit me rëndësi strategjike dhe kombëtare, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

g) Dhënia e licencës bëhet mbi bazën e kriterëve të eficiencës dhe balancës ekonomike për operatorin e sistemit dhe duke siguruar që veprimtaria e të licencuarit të kryhet në përputhje me të drejtat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

Termat dhe përkufizimet e përdorura mbi:

Ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”; “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”; “Rregulloren mbi procedurat

e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”; “Rregulloren për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”; “Rregullat dhe rregulloret që i përkasin sektorit të gazit natyror”, përfshihen në këtë licencë për çdo qëllim.

Fjalë dhe fraza të tjera, të përdorura në këtë licencë dhe në kushtet e licencës, të cilat nuk përfshihen në ligjet dhe rregulloret e mësipërme, kanë kuptimet si më poshtë vijon:

“Aktivitet i licencuar” do të thotë aktivitetet e lidhura direkt dhe të nevojshme për operimin dhe përdorimin e sistemit të transmetimit në territorin e licencës për të transportuar gazin natyror dhe aktivitetet e lidhura me komprimimin, matjet, marrjen, depozitimin, livrimin, aktivitetet e dispecerimit dhe kontrollit të funksionimit/ operimit të sistemit të transmetimit, operimi me sistemet e tjera të gazit natyror, mjetet dhe burimet e tjera të nevojshme për të siguruar stabilitetin, besueshmërinë, sigurinë dhe funksionimin/ operimin efikas të sistemit të gazit natyror.

“I licencuar” do të thotë personi i pajisur me një licencë dhënë nga ERE për të kryer aktivitete në transmetimin e gazit natyror, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

“Bordi i ERE-s” ose “Bordi” do të thotë organi vendimmarrës i ERE-s që përbëhet nga pesë anëtarë të emëruar sipas procedurave të parashikuara nga ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligji nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror.”

“ERE” do të thotë Enti Rregullator i Energjisë, që vepron në bazë të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

“Licencë” do të thotë një e drejtë e dhënë nga ERE për ushtrimin e një veprimtarie të transmetimit të gazit natyror në përputhje me ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

“Informacion me ndjeshmëri tregtare” do të thotë të dhëna në lidhje me biznesin ose me natyrë tregtare të përdoruesve të sistemit që zotërohen nga i licencuari gjatë procesit të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, të cilat duhet të mbahen konfidenciale.

“Informacion me avantazh tregtar” do të thotë informacion i lidhur me aktivitetin e vetë të licencuarit, i cili duhet të mbahet konfidencial dhe nuk duhet t’i jepet apo t’i bëhet i ditur të tjerëve në mënyrë diskriminuese.

“Ndërsubvencionim” do të thotë transferimi i fondeve ose ndarje e kostove ndër llogaritë e të licencuarit ose llogaritë e bizneseve të lidhura me qëllim mbështetjen financiare të një aktiviteti apo biznesi, përveç transmetimit të gazit natyror nga të ardhurat e marra nga i licencuari që kryen aktivitetin e licencuar ose transferimin e shpenzimeve të bëra nga i licencuari gjatë ushtrimit të aktivitetit të licencuar tek ndonjë aktivitet ose biznes tjetër nga ai i transmetimit të gazit natyror.

“Përdorues i sistemit të transmetimit ose përdorues i sistemit” do të thotë personi që kryen aktivitet në sistemin e gazit natyror si, për shembull: prodhuesit, shpërndarësit, furnizuesit, tregtarët, konsumatorët e kualifikuar lidhur në sistemin e transmetimit dhe që përfitojnë nga shërbimet e transmetimit.

“Procedurat e licencimit për sektorin e gazit natyror” do të thotë Rregullorja e hartuar nga ERE me titull: “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017.

“Legjislacioni në fuqi” do të thotë të gjitha standardet, kodet, rregullat, rregulloret, metodologjitë dhe çdo vendim ose akt tjetër në fuqi, të miratuara nga ERE dhe autoritete të tjera kompetente sipas ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

“Sistem i transmetimit” do të thotë rrjeti i tubacioneve të presionit të lartë, stacionet e kompresorëve, pajisjet e matjes, si dhe gjithë pajisjet dhe impiantet e tjera të nevojshme për kryerjen e aktivitetit të transmetimit të gazit natyror në territorin e licencës.

“Tarifë e shërbimeve ndihmëse” do të thotë pagesa që i licencuari aplikon ndaj përdoruesve të sistemit e përcaktuar nga ERE në përputhje me metodologjinë për llogaritjen e tarifave për shërbimet ndihmëse dhe ato të balancimit, e miratuar nga ERE në përputhje me ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

“Tarifë e shërbimit të transmetimit ose tarifë e transmetimit” do të thotë pagesa që i licencuari aplikon

ndaj përdoruesve të sistemit e vendosur nga ERE sipas metodologjisë së llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror miratuar me vendimin nr. 178, datë 8.11.2017, të bordit të ERE-s.

“Territori i licencës” do të ketë kuptimin e përcaktuar në nenin 2 të kësaj licence.

Neni 2

Territori i ushtrimit të aktivitetit të licencuar

1. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, rregullat dhe rregulloret e zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri, i licencuari do të ushtrorë aktivitetin e licencuar për transmetimin e gazit natyror në sistemin e transmetimit në territorin e licencës.

2. Territori i licencës, ku i licencuari autorizohet të kryejë aktivitetin e licencuar, do të jetë i gjithë territori shqiptar, përfshirë sistemin e transmetimit në vend dhe interkoneksionet me sistemet fqinje të transmetimit, të cilat zotërohen dhe operohen nga i licencuari.

3. Tubacionet e gazit natyror të cilat përbëjnë sistemin e transmetimit në zotërim dhe operim të të licencuarit brenda territorit të licencës në datën efektive të licencës janë të vendosura te shtojca e Kushteve të Licencimit. Mund të paraqiten ndryshime në shtojcë sipas pikës 15 të Kushteve të Licencimit.

4. Territori i licencës i përcaktuar sipas pikës 2, të nenit 2 duhet të përjashtojë tubacionet e transmetimit dhe/ose interkonektorët të cilët nuk zotërohen nga i licencuari dhe operimi i të cilave kryhet nga një operator tjetër i certifikuar dhe i licencuar nga ERE.

PJESA E DYTË

Neni 3

Detyrimet operationale të të licencuarit

1. I licencuari autorizohet që sipas kësaj licence të kryejë aktivitetin e licencuar në territorin e licencës.

2. Të jetë i certifikuar konform nenit 37, të ligjit nr. 102/2015, “Për gazin natyror”, sipas vendimit të ERE-s, si dhe të zbatojë të gjitha detyrimet që burojnë nga certifikimi.

3. I licencuari do të operojë, do të përdorë dhe do të zhvillojë, në varësi të kushteve ekonomike, një sistem të sigurt, të besueshëm dhe eficient të transmetimit për të siguruar tregun e gazit natyror në Shqipëri dhe për të siguruar kapacitet të mjaftueshëm për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për transmetimin e gazit natyror në territorin e licencës dhe mjetet e nevojshme për të përmbushur detyrimet e shërbimit.

4. Jo më vonë se 6 muaj nga data efektive e kësaj licence, i licencuari do të përgatisë dhe do të dorëzojë për miratim në ERE një propozim të Kodit të Sistemit të Transmetimit, sipas nenit 44, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

5. I licencuari do të sigurojë që sistemi i transmetimit dhe gjithë tubacionet dhe facilitetet e tjera, përfshirë stacionet e kompresorëve, reduktorët e presionit, matësit dhe çdo pajisje tjetër janë ndërtuar dhe mirëmbahen sipas kushteve dhe standardeve teknike në fuqi, rregullat teknike dhe të sigurisë në sektorin e gazit natyror. Ndërtimi dhe përdorimi i tubacioneve të gazit dhe infrastrukturës duhet t’u nënshtrohen autorizimeve që kërkohen, sipas nenit 11, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

6. I licencuari është i detyruar që pas hyrjes në fuqi të kësaj licence, sipas nenit 46, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe legjislacionit në fuqi, të përgatisë dhe të paraqesë në ERE planin dhjetëvjeçar për zhvillimin e rrjetit të transmetimit dhe kushteve të kësaj licence. I licencuari duhet të paraqesë në ERE planin e rishikuar dhjetëvjeçar për zhvillimin e rrjetit të transmetimit jo më vonë se data 31 tetor e çdo viti. Plani dhjetëvjeçar për zhvillimin e rrjetit të transmetimit bëhet detyrues për të licencuarit, pasi të jetë konsultuar, miratuar dhe publikuar nga ERE. Zbatimi i planit dhjetëvjeçar për zhvillimin e rrjetit të transmetimit monitorohet, hartohet dhe vendoset në fuqi nga ERE, sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”. Plani dhjetëvjeçar i zhvillimit të rrjetit të transmetimit duhet të bazohet te furnizimi ekzistues dhe parashikimet me gaz natyror dhe kërkesa në

Shqipëri, dhe duhet të përmbajë masat për të garantuar përshtatshmërinë e sistemit të transmetimit dhe sigurinë e furnizimit. Plan i dhjetëvjeçar i zhvillimit të rrjetit të transmetimit duhet të mbajë në mënyrë të veçantë:

a) Një përshkrim të situatës aktuale të sektorit të gazit natyror në territorin e licencës në vend dhe në rajon;

b) Lidhjet aktuale të sistemit të transmetimit me sistemet e tjera të transmetimit, depozitimit të GNL-së dhe të shpërndarjes në vend dhe në rajon, kapacitetet e interkoneksioneve, nivelin e ndëroperimit të sistemit të transmetimit me sistemet fqinje;

c) Parashikimi i nevojave për zgjerim e kapaciteteve të sistemit të transmetimit dhe aftësive të tij funksionale;

d) Rishikim i kongjestioneve aktuale dhe i atyre që parashikohen në sistemin e transmetimit dhe aplikohen për masat e menaxhimit të kongjestioneve;

e) Vendndodhjet ku është planifikuar të zhvillohet ose të ndërtohet sistemi i transmetimit të gazit natyror dhe nëse është e nevojshme ndryshimet në territorin e licencës për t'u miratuar nga ERE;

f) Informacion mbi infrastrukturën e sistemit kryesor të transmetimit që duhet të ndërtohet ose të përditësohet për dhjetë vitet e ardhshme;

g) Investimet e miratuara për sistemin e transmetimit dhe investimet e reja të cilat parashikohen të kryhen për tri vitet e tjera;

h) Afatet kohore të kryerjes të investimeve; dhe

i) Burimet financiare për zbatimin e planit.

7. Gjatë shtjellimit të planit dhjetëvjeçar për zhvillimin e rrjetit të transmetimit, i licencuari duhet të bëjë parashikime të arsyeshme në lidhje me prodhimin, furnizimin, konsumin dhe shkëmbimin e gazit natyror me vendet e tjera, duke pasur në konsideratë investimet e planifikuara për sistemet e interkonektuara, si dhe hapësirat e parashikuara dhe zhvillimet e GNL-së.

8. Në kushtet kur i licencuari, me përjashtim të arsyeve jashtë kontrollit të tij, nuk kryen një investim, i cili, sipas planit planin dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit të transmetimit duhet të ishte kryer në vitin në vijim, ERE do të ndërmarrë vendimet e nevojshme, në përputhje me nenin 46, të ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror" dhe legjislacionin në fuqi.

9. I licencuari do të lejojë hyrjen e palëve të treta në sistemin e transmetimit sikurse përcaktuar më tej në nenin 9 të kushteve të kësaj licence.

10. I licencuari nuk do të pengojë ose tentojë të pengojë pjesëmarrësit e tjerë të tregut apo konkurrentë të ndryshëm që synojnë të angazhohen, në:

a) Një biznes të gazit natyror në Republikën e Shqipërisë; apo

b) Import ose eksport të gazit natyror në ose nga Republika e Shqipërisë.

11. I licencuari nuk do të vendosë pagesë tjetër për shërbimet e transmetimit dhe shërbimet ndihmëse, përveç tarifës së aprovuar nga ERE.

12. I licencuari nuk do të angazhohet në ndërsuvencionime. Në përputhje me nenin 30, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror" dhe legjislacionit në fuqi, i licencuari duhet të mbajë llogari të ndara për secilin nga aktivitetet e licencuara që ai ushtron dhe llogari të ndara për aktivitetet tjera, të cilat mund të konsolidohen, në mënyrë të tillë që të bindin ERE-n dhe çdo autoritet tjetër kompetent se nuk ka ndërsuvencionime, nuk cenon konkurrencën në treg dhe nuk ndikon në aktivitetin e të licencuarit. I licencuari duhet të hartojë, paraqesë për auditim dhe publikojë kontrollet vjetore sipas termave dhe kushteve të përcaktuar në ligjet që aplikohen në Shqipëri dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

13. I licencuari nuk do të angazhohet në asnjë formë monopoli ose aktivitete të tjera që dëmtojnë konkurrencën. Kjo nuk duhet të cenojë autorizimin ekskluziv të dhënë për të licencuarin për të kryer aktivitetin e licencuar në territorin e licencuar, sipas nenit 23(2), të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit

natyror” dhe pikës 3 të këtyre kushteve të licencimit.

14. Gjatë kryerjes së aktivitetit të licencuar, i licencuari është përgjegjës për sigurinë e shëndetit dhe jetës së njerëzve, të pronës së tyre, si dhe për dëmtimin e ambientit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ku përfshihen rregullat teknike dhe ato të sigurisë në sektorin e gazit natyror dhe rregullat dhe rregulloret e miratuara nga ERE. I licencuari do të lidhë dhe do të mbajë kontrata sigurimi, me shoqëri sigurimi të licencuara, sipas legjislacionit në fuqi, me limit detyrimesh jo më pak se 10 milionë \$, për të mbuluar detyrimet e të licencuarit që lidhen me këtë licencë dhe sipas legjislacionit në fuqi. ERE dhe shteti shqiptar do të përfshihen si të siguruar shtesë në politikat e sigurimit pa kosto shtesë për ERE-n dhe shtetin shqiptar.

15. Në qoftë se i licencuari përballet ose parashikon një situatë emergjence që kërcënon jetën ose shëndetin e njerëzve ose sigurinë e pronës së tyre, ambientin, qëndrueshmërinë e sistemit të transmetimit ose sigurinë e furnizimit, atëherë i licencuari ndërmerr hapat e nevojshëm për të përmirësuar ose për të parandaluar ndikimet e situatës emergjente aktuale ose të pritshme, sipas ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, planet e emergjencës të miratuara nga Këshilli i Ministrave, Kodin e Rrjetit të Transmetimit, rregullat teknike dhe të sigurisë në sektorin e gazit natyror dhe/ose legjislacionit në fuqi. Pa vonesë, në vijim, i licencuari duhet të njoftojë ERE-n dhe çdo autoritet tjetër të nevojshëm për situatën emergjente dhe veprimet ose planet e të licencuarit, për menaxhimin e kësaj situate.

16. I licencuari nuk do të angazhohet i vetëm ose së bashku me persona të tjerë, në aktivitete të cilat kanë për qëllim ose mund të dëmtojnë natyrën e drejtë, të hapur dhe jodiskriminuese të sistemit të transmetimit dhe tregut të gazit natyror. I licencuari mund të bashkëpunojë me persona të tjerë në aspekte të sigurisë, qëndrueshmërisë dhe përmirësimit të sistemit të transmetimit, pa ndikuar te pavarësia e detyrueshme dhe ndarja sipas neneve 35 dhe 36, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe përgjegjësinë ekskluzive për të kryer aktivitetin e licencuar, sipas termave dhe kushteve të përcaktuar në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, legjislacionit në fuqi dhe kushteve të kësaj licence.

17. I licencuari kryen aktivitetin e licencuar, zhvillon politika dhe programe, si edhe merr masat e nevojshme për përmirësimin dhe nxitjen e eficiencës ekonomike dhe operacionale të sistemit të transmetimit dhe siguron që furnizimi me gaz natyror të kryhet në përputhje me kërkesat praktikat e legjislacionit shqiptar dhe standardet evropiane, lidhur me cilësinë e shërbimit dhe qëndrueshmërinë e sistemit të transmetimit.

18. I licencuari nuk do të përfshihet në aktivitete që në mënyrë direkte ose të tërthortë ndikojnë në performancën e aktivitetit të tij. I licencuari duhet të informojë ERE-n, në rast se ka qëllim të:

- a) Angazhohet në aktivitete të tjera, përveç aktivitetit të licencuar; ose
- b) Të ngrejë një biznes shoqërues.

ERE mund të ndalojë ose të vendosë kushte të veçanta për angazhimin e të licencuarit në aktivitete të ndryshme nga ai i licencuar dhe për ngritjen e bizneseve shoqëruese, për të mbrojtur përdoruesit e sistemit dhe shmangien e ndërsbvencionimeve.

19. I licencuari është i autorizuar të faturojë pagesa për ofrimin e shërbimeve të transmetimit dhe shërbimeve ndihmëse sipas tarifave të miratuara nga ERE.

20. I licencuari nuk është përgjegjës për mosplotësimin e kushteve të licencës në rastin e ndodhjes së forcës madhore, në masën dhe për periudhën në të cilën forca madhore nuk lejon plotësimin e kushteve të licencës. Në rastin e forcës madhore, i licencuari duhet të njoftojë menjëherë ERE-n dhe përdoruesit e tjerë të sistemit, me të cilët ka lidhur kontratë. I licencuari do të rivendosë shërbimin e ndërprerë sipas termave dhe kushteve të përcaktuar në Kodin e Rrjetit të Transmetimit dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 4

Kontrolli i centralizuar dhe koordinimi i sistemit të transmetimit

1. I licencuari duhet të drejtojë dhe koordinojë operimin e sistemit të transmetimit, në përputhje me

Kodin e Sistemit të Transmetimit, rregullat dhe rregulloret e miratuara nga ERE.

2. Për sigurimin e koordinimit të aktivitetit të licencuar dhe operimin efektiv e të qëndrueshëm të sistemit të transmetimit, i licencuari instalon, përdor dhe mirëmban pajisjet e nevojshme për mbrojtjen e sistemit të transmetimit nga gabimet operationale, humbjet e linjës apo çdo ngjarje tjetër të mundshme, e cila mund të ketë efekt të dëmshëm në sistemin e transmetimit ose pajisjet e instalimet e lidhura me të.

3. I licencuari do të ofrojë shërbimin e transmetimit dhe shërbimet ndihmëse, në përputhje me Kodin e Sistemit të Transmetimit dhe legjislacionit në fuqi.

4. I licencuari duhet të planifikojë dhe të marrë masat për sigurimin e furnizimit me gaz natyror, sipas standardeve të vendosura në planin e emergjencave, sipas nenit 6, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, dhe duhet të jetë përgjegjës për sigurimin e furnizimit me gaz natyror, në përputhje me kompetencat e tij gjatë ushtrimit të aktivitetit.

Neni 5

Ndryshimet në sistemin e transmetimit

1. I licencuari do të njoftojë menjëherë ERE-n për çdo rrethanë që çon në ndryshime të rëndësishme të kapacitetit transmetues të linjave dhe stacioneve të kompresorëve të sistemit të transmetimit, për një periudhë më të gjatë se tridhjetë (30) ditë dhe do t'i paraqesë ERE-s opinionin e tij për zgjidhjen më të përshtatshme për të reduktuar ndikimin e dëmshëm.

2. I licencuari do të informojë ERE-n për planet për reduktimin e presionit të tubacioneve ose të pajisjeve të sistemit të transmetimit, të paktën dymbëdhjetë (12) muaj para reduktimit të planifikuar dhe do t'i paraqesë ERE-s një shpjegim të detajuar të veprimeve dhe masave që do të merren për të zvogëluar ndikimin negativ të mundshëm.

3. I licencuari nuk do të lidhë kontrata për të cilat është ose duhet të jetë në dijeni të pasojave që përbëjnë shkelje të kushteve të licencës.

4. I licencuari mund të pezullojë shërbimet e sistemit të transmetimit për një apo më shumë përdorues të sistemit, për një periudhë kohe, kur veprimi apo mosveprimi i një personi rrezikon qëndrueshmërinë, sigurinë dhe cilësinë e shërbimeve të transmetimit për përdoruesit e tjerë të sistemit të transmetimit ose mund të pengojë përmbushje të kushteve të licencës. I licencuari, pa vonesë duhet të njoftojë ERE-n dhe ndonjë person tjetër të prekur nga kjo situatë, lidhur me veprimet e pezulluara sipas këtij paragrafi. Këto njoftime duhet të përmbajnë një opinion të argumentuar në lidhje me natyrën, madhësinë dhe periudhën e zgjatjes së këtyre pezullimeve. I licencuari, në zbatim të Kodit të Rrjetit të Transmetimit dhe legjislacionit në fuqi duhet të rivendosë ofrimin e shërbimeve që janë pezulluar.

5. I licencuari kryen balancimin e sistemit, mbështetur në parime objektive, transparente e jodiskriminuese, në përputhje me rregullat balancuese, sipas nenit 34, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”. Çmimet për ofrimin e shërbimeve të balancimit do të përcaktohen në bazë të metodologjisë së miratuar nga ERE.

6. I licencuari siguron ofrimin e shërbimeve të sistemit, në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese, në bazë të parimit të kostos më të ulët dhe ndikimit mjedisor më të ulët.

7. I licencuari zbaton dhe publikon mekanizmat jodiskriminues dhe transparentë për ndarjen e kapaciteteve dhe procedurat për menaxhimin e kongjestioneve, sipas nenit 45, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe Kodit të Rrjetit të Transmetimit.

8. I licencuari ndërton kapacitete të mjaftueshme ndërkufitare për të integruar sistemin e transmetimit të gazit natyror të Shqipërisë me sistemin analog të vendeve anëtare të BE-së dhe palëve kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, duke përmbushur të gjitha kërkesat e nevojshme ekonomike dhe teknike të realizueshme për kapacitetin, si dhe duke marrë parasysh sigurinë e furnizimit me gaz.

9. I licencuari i siguron çdo përdoruesi të sistemit të transmetimit, OSSH-së, operatorit të impiantit të depozitave, operatorit të impiantit të GNL-së, OST-së fqinje ose shoqërive të tjera të licencuara në sektorin

e gazit natyror, informacion të mjaftueshëm se transporti dhe depozitimi i gazit natyror do të jetë në përputhje me mundësinë për të siguruar ndërveprimin e sigurt dhe eficient të sistemeve të ndërlidhura.

10. I licencuari i siguron përdoruesve të sistemit informacion të hollësishëm, të kuptueshëm dhe të arritshëm për shërbimet e ofruara, kushtet e shërbimit dhe informacionin e nevojshëm teknik për përdoruesit e rrjetit, për t'u mundësuar një akses efektiv në rrjet, përfshirë, por pa kufizuar, kapacitetet teknike të kontraktuara dhe të disponueshme, në përputhje me informacionin konfidencial të përjashtimeve, informacionin konfidencial për përjashtimet, të miratuar nga ERE.

11. I licencuari siguron energji për kryerjen e funksioneve të tij, sipas procedurave transparente, jodiskriminuese dhe në përputhje me tregun.

12. I licencuari ruan dhe vendos në dispozicion të autoriteteve përgjegjëse të gjithë informacionin e përmendur në nenin 48, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", për një periudhë pesëvjeçare. Ky informacion duhet të vendoset në dispozicion edhe të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

13. I licencuari ndërmerr të gjitha masat e nevojshme që të drejtat e kapaciteteve të jenë lirisht të tregtueshme, duke marrë në konsideratë që ky proces të kryhet në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese. I licencuari harton kontrata të harmonizuara të transportit dhe procedurat për tregun primar, me qëllim lehtësimin e tregut sekondar të kapaciteteve dhe pranimin e transferimit të të drejtave të kapaciteteve fillestare të njoftuara nga përdoruesit e sistemit. Këto kontrata të harmonizuara dhe procedura i njoftohen ERE-s.

14. I licencuari ruan konfidencialitetin e çdo informacioni të ndjeshëm tregtar.

15. I licencuari ushtron aktivitetin e tij në përputhje me standardet minimale teknike të miratuara nga ministria përgjegjëse për energjinë, për mirëmbajtjen, për zhvillimin, për inspektimin teknik të sistemit të transmetimit të gazit natyror dhe për kapacitetin ndërlidhës, sipas ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror".

16. I licencuari vendos dhe zbaton programin e pajtueshmërisë, duke përcaktuar masat e marra për të siguruar përjashtimin e sjelljes diskriminuese, sipas miratimit nga ERE dhe emëron një zyrtar pajtueshmërie, sipas nenit 47, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror".

17. I licencuari nxit, lehtëson dhe siguron bashkëpunim rajonal dhe ndërkombëtar, sipas nenit 49, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror".

18. I licencuari kryen detyrat e tjera të përcaktuara brenda kushteve të kësaj licence, sipas ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", si dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 6

Detyrimet për raportim të të licencuarit

1. Deri në datën 15 shkurt të çdo viti, i licencuari dërgon në ERE një raport për aktivitetin operacional për vitin paraardhës. ERE mundet të vendosë kushte të veçanta për formën e raportimit.

2. Raporti vjetor do të paraqesë analizën e veprimtarisë operationale të të licencuarit dhe do të trajtojë minimalisht çështjet që vijojnë:

a) Volumin e gazit natyror të transmetuar gjatë vitit paraardhës (sasia totale e gazit natyror të transmetuar, numrin e përdoruesve të shërbyer), si dhe krahasime me vitet pararendëse;

b) Masat e marra gjatë vitit për të cilin raportohet, për:

i) mbrojtjen e mjeteve dhe pajisjeve nga ndikimet e jashtme dhe defektet dhe sigurimin e mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme për aktivitetin e licencuar;

ii) sigurinë në punë;

iii) mbrojtjen e ambientit dhe të shëndetit të njerëzve;

iv) monitorimin e operimit të sistemit të transmetimit;

v) plotësimin e kushteve për një aktivitet të qëndrueshëm, të vazhdueshëm dhe me cilësi;

vi) plotësimin e kushteve për eficiencën e përdorimit të gazit; dhe

- vii) analizën e rasteve të emergjencës dhe masave parandaluese;
- c) Realizimin e planit dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit të transmetimit, të miratuar nga ERE për vitin paraardhës;
- d) Zbatimin e programit të riparimeve dhe të mirëmbajtjes në vitin raportues;
- e) Inspektimet, supervizimet dhe kontrollet e kryera nga organet kompetente, duke i shoqëruar me fotokopje të raporteve, analizave dhe vendimeve përkatëse;
- f) Një parashikim paraprak 10-vjeçar të planit të zhvillimit të rrjetit të transmetimit, i cili do të zbatohet konform pikës 4.6 të kushteve të kësaj licence;
- g) Realizimin e detyrimit për të mbajtur të informuar konsumatorët dhe masat e marra për përmirësimin e cilësisë së shërbimit;
- h) Të dhëna të tjera dhe informacion tjetër që kërkohet për paraqitjen sipas kërkesave të miratuara të ERE-s për monitorimin dhe raportimin.

3. Në çdo kohë, i licencuari duhet të disponojë dhe të vendosë në dispozicion të ERE-s të dhëna të sakta, mbi:

- Vendndodhjen e instalimeve dhe gjurmën e tubacioneve, përfshirë hartën topografike;
- Zonën gjeografike të mbuluar;
- Kapacitetin maksimal teknik të kontraktuar dhe të disponueshëm në të gjitha pikat e hyrjes (*in take*) në sistem dhe të daljes (*off take*) prej sistemit dhe ndërlidhjet e tij me rrjetet e tjera të transmetimit dhe të shpërndarjes, impiantet e magazinimit, prodhimin dhe terminalin e GNL-së;
- Volumet e projektuara për t'u përpunuar sipas vlerësimeve të tij;
- Standardet teknike, presionet maksimale të projektuara, kërkesat e komprimimit dhe karakteristikat e tjera teknike të makinerive dhe pajisjeve teknike që do të instalohen;
- Presionet e punës të projektuara mbështetur në vlerësimet e tij;
- Kategoritë e konsumatorëve dhe livrimet e projektuara.
- Vendndodhjet e matësve dhe specifikimet;
- Planet e aromatizimit përfshirë vendndodhjet;
- Dëshmi të kontratave/angazhimeve;
- Programin e punës për zbatimin e projektit dhe jeta e pritshme e projektit;
- Sasia mesatare e gazit natyror që parashikohet për t'u transmetuar gjatë një viti mbështetur në një program tipik mujor.

Neni 7

Raportimi financiar

1. I licencuari mban libra llogarie dhe përgatit bilance financiare, të cilat do të mbahen të ndara për aktivitetin e licencuar, si dhe për çdo aktivitet tjetër (përfshirë aktivitete të tjera të licencuara), ku është angazhuar i licencuari, neni 30, i ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", në përputhje me udhëzimet për veçimin e llogarive të miratuara nga ERE dhe në përputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Deri në datën 30 qershor të çdo viti, i licencuari dorëzon në ERE pasqyrat financiare të audituara, të shoqëruara me:

- Bilancin;
- Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve;
- Pasqyrën e ndryshimeve në kapital;
- Pasqyrën e fluksit të parasë;
- Shënime shpjeguese.

2. I licencuari do të ndajë shpenzimet e përbashkëta midis aktivitetit të tij të licencuar dhe tipave të tjerë të aktiviteteve (përfshirë aktivitetet e autorizuara nga leje të tjera apo koncesione), në bazë të arsyeshme, në përputhje me rregullat dhe rregulloret e ERE-s dhe praktikat e biznesit, përgjithësisht të pranuar. Në

përputhje me kërkesat e pikës 4.10 të kushteve të kësaj licence dhe me kërkesë të ERE-s, i licencuari dorëzon në ERE pasqyrat financiare të audituara, të cilat mbulojnë të gjitha aktivitetet e të licencuarit dhe që tregojnë se nuk ka ndërsbvencionime në lidhje me aktivitetin e licencuar. Me kërkesë të ERE-s, i licencuari dorëzon në ERE edhe shpjegimet që justifikojnë bazat për alokimin e shpenzimeve të përgjithshme të kryera nga i licencuari.

Neni 8 **Njoftimet**

1. I licencuari duhet të njoftojë ERE-n brenda 10 (dhjetë) ditëve për çdo ndryshim, në:
 - a) Adresën zyrtare;
 - b) Statutin e të licencuarit;
 - c) Certifikatën e regjistrimit;
 - d) Kodin fiskal;
 - e) Përfaqësuesit zyrtarë apo organet e tjera drejtuese;
 - f) Ndryshimin e strukturës së aseteve nga 10% ose më tepër;
 - g) Çdo ndryshim tjetër në organizimin dhe operimin e të licencuarit, i cili mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në aktivitetin e të licencuarit.
2. Gjithë njoftimet zyrtare, aplikimet, peticionet, pretendimet ose korrespondenca tjetër me ERE-n lidhur me licencën duhet të jetë me shkrim dhe të nënshkruara respektivisht nga një zyrtar i autorizuar ose përfaqësues i caktuar i të licencuarit dhe ERE-s, sipas rastit dhe të dërgohet me korrier ose me postë të regjistruar, duke kërkuar një verifikim të fletës së marrjes së njoftimit. Adresat e palëve duhet të vendosen mbi zarf. Gjithë njoftimet ose korrespondenca tjetër do të konsiderohen se hyjnë në fuqi nga momenti i dorëzimit ose nëse nuk janë dorëzuar për shkak të gabimit të dërguesit, nga momenti i prezantimit.

PJESA E TRETË

Neni 9

Aksesi i palëve të treta në sistemin e transmetimit dhe përjashtimi prej kësaj të drejte

1. Në përputhje me nenin 42, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, Kodin e Rrjetit të Transmetimit dhe legjislacionin në fuqi, i licencuari do të sigurojë hyrjen e palëve të treta në sistemin e transmetimit në territorin e licencës të përdoruesve të sistemit në mënyrë të drejtë, transparente dhe pa diskriminim.
2. I licencuari mund të refuzojë aksesin në sistemin e transmetimit vetëm në rrethanat e parashikuara në nenin 43, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.
3. Në rast të ndërtimit të infrastrukturave të reja ose zgjerimit të konsiderueshëm të kapaciteteve ekzistuese të sistemit të transmetimit në territorin e licencës, i licencuari mund të kërkojë që ERE ta përjashtojë nga detyrimi i së drejtës së aksesit të palëve të treta, në përputhje me nenin 78, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe rregullat dhe rregulloret e miratuara prej ERE-s.

Neni 10

Braktisja dhe rehabilitimi

1. Në përputhje me rregullat dhe rregulloret në fuqi, i licencuari braktis pajisjet dhe impiantet dhe rehabiliton vendndodhjen e pajisjeve dhe mjedisin përreth në rastet, kur:
 - a) Pajisjet dhe impiantet janë jashtë shërbimi, të dëmtuara dhe nuk janë riparuar gjatë një periudhe prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh kalendarikë; dhe
 - b) I licencuari nuk ka njoftuar ERE-n që ai ka ndërmend të përdorë, riparojë apo zëvendësojë këto pajisje dhe impiante.

2. I licencuari duhet të ndërmarrë menjëherë veprimet e nevojshme për zhvendosjen e pajisjeve të braktisura dhe të bëjë restaurimin e zonës në kushtet që ajo ka qenë para fillimit të ushtrimit të aktivitetit të licencuar dhe të riparojë çdo dëm të ambientit të shkaktuar si rezultat i veprimtarisë së të licencuarit.

3. Të gjitha shpenzimet për braktisjen e pajisjeve apo faciliteteve dhe rehabilitimin e zonës dhe ambientit janë në llogari të të licencuarit.

4. I licencuari do të mbajë ERE-n dhe shtetin shqiptar jashtë çdo kostoje zhdëmtimi dhe përgjegjësie tjetër, përfshirë rehabilitimin e dëmtimeve mjedisore të shkaktuara ose që kanë ardhur si pasojë e gabimeve të të licencuarit në ushtrimin e aktivitetit sipas kësaj licence.

PJESA E KATËRT

Neni 11

Pagesat rregullatore

I licencuari duhet të paguajë në ERE pagesat, në mënyrë të rregullt, gjatë gjithë kohës së mbajtjes së licencës, në përputhje me nenin 14, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe rregullave dhe rregulloreve të ERE-s. Në qoftë se i licencuari nuk paguan këto pagesa në sasinë dhe kohën e caktuar, atëherë ai penalizohet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 12

Tarifat

1. Tarifa për shërbimet e transmetimit të të licencuarit dhe tarifa e shërbimeve ndihmëse, duhet të rregullohet dhe miratohet nga ERE, sipas metodologjisë përkatëse.

2. Tarifa e transmetimit e aprovuar nga ERE do të vendoset për të siguruar të licencuarin, me:

a) Të ardhura të mjaftueshme për mbulimin e niveleve të arsyeshme të kostove, përfshirë koston e kapitalit;

b) Sigurimin e një norme të arsyeshme fitimi; dhe

c) Nxitje (insentiva) për reduktimin e kostove dhe operimin në mënyrë më eficiente.

3. Për sasinë e gazit natyror të transmetuar nga i licencuari, si edhe për shërbimet ndihmëse, i licencuari autorizohet të vendosë pagesa për të gjithë përdoruesit e sistemit të transmetimit, me kusht që këto pagesa të jenë sipas tarifës së aprovuar nga ERE. Vlera e këtyre pagesave përcaktohet mbi bazën e vendosjes së tarifave dhe sasinë e gazit të regjistruar në matësit e instaluar, në:

a) Kufirin e sistemit të transmetimit dhe të sistemit të shpërndarjes;

b) Kufirin e sistemit të transmetimit dhe të konsumatorëve, të cilët marrin lidhje direkt me sistemin e transmetimit;

c) Interkoneksionet me sistemet e tjera të transmetimit.

4. Bazuar në aplikimin e të licencuarit ose me iniciativën e saj, ERE mund të rishikojë tarifën e transmetimit dhe/ose tarifën e shërbimeve mbështetëse dhe t’i ndryshojë ato, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe metodologjitë përkatëse.

Neni 13

Matja dhe sistemi i raportimit

1. I licencuari do të regjistrojë, në bazë orare, gjithë volumet e gazit natyror që hyjnë ose dalin nga sistemi i transmetimit. Në vendet ku nuk ka matës ose kur matësit nuk regjistrojnë në mënyrë korrekte, i licencuari do të përcaktojë sasinë orare të gazit të transmetuar, në përputhje me Kodin e Sistemit të Matjes, miratuar nga ERE dhe do të ndërmarrë pa vonesë masa për instalimin ose për riparimin e pajisjeve të nevojshme matëse.

2. I licencuari mban raporte të detajuara mujore për sasinë e gazit që hyjnë dhe dalin në sistemin e

transmetimit, operimin e sistemit të transmetimit, balancimin, shërbimet ndihmëse dhe detaje të tjera të sistemit të transmetimit.

3. I licencuari u dorëzon mbi baza mujore të gjithë përdoruesve të sistemit të transmetimit, me të cilët ka lidhur kontrata për sigurimin e shërbimeve të transmetimit, të dhëna lidhur me sasinë e gazit të transmetuar, në përputhje me kontratën e lidhur me çdo përdorues.

PJESA E PESTË

Neni 14

Monitorimi i performancës së aktivitetit të licencuar

1. ERE monitoron të licencuarin lidhur me zbatimin e kushteve të licencës, shqyrton raportet e të licencuarit dhe, kur e shikon të arsyeshme, ERE inspekton asetet, llogaritë apo të dhëna të tjera dhe kërkon auditimin e aktiviteteve të të licencuarit. Kostot e auditimeve janë për llogari të të licencuarit. Për këtë qëllim, ERE, midis të tjerave duhet të ketë akses të pakufizuar te llogaritë e të licencuarit, sipas nenit 30 dhe 31, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

2. ERE monitoron pajtueshmërinë e të licencuarit me kërkesat për ndarjen dhe pavarësinë, sipas nenit 39, të ligjit 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”. Sipas kushteve të parashikuara në ligj, ERE ka të drejtën të rishikojë vendimin e certifikimit të të licencuarit dhe kur është e nevojshme të rihapë procedurën e certifikimit, sipas nenit 40, të ligjit 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”. Me hapjen e procedurës së certifikimit, ERE mund të vendosë për modifikimin ose për heqjen e licencës, sipas ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe legjislacionit në fuqi.

3. Në vijim të një ankese të argumentuar të një pale të tretë apo me iniciativën e vet, ERE mund të fillojë një investigim të pajtueshmërisë së aktivitetit të të licencuarit me kushtet e licencës dhe rregullat dhe rregulloret e ERE-s.

4. I licencuari duhet të sigurojë akses të plotë përfaqësuesve të autorizuar të ERE-s në dokumentacionin dhe raportet e të licencuarit për të kontrolluar aktivitetin e licencuar, në përputhje me rregullat dhe rregulloret e miratuara nga ERE. I licencuari duhet të japë të gjithë ndihmën e nevojshme gjatë procesit të kontrollit.

5. Në qoftë se pas investigimit, ERE arrin në përfundimin që i licencuari nuk ka përmbushur kushtet e licencës, ERE mund të rishikojë tarifën e të licencuarit dhe/ose merr masat e nevojshme, në përputhje me ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, rregullat dhe rregulloret, me qëllim mbrojtjen e interesave të përdoruesve të sistemit të transmetimit dhe konsumatorëve të gazit natyror.

6. I licencuari duhet të informojë ERE-n për çdo shkelje të kushteve të licencës, brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike nga dita e marrjes dijeni të një fakti të tillë.

7. I licencuari duhet të zbatojë të gjitha vendimet e marra nga ERE, përfshirë pagesat e gjobave të vendosura nga ERE, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 15

Cilësia e shërbimit

1. I licencuari është i detyruar:

a) Të sigurojë shërbim cilësor të transmetimit të gazit natyror që lidhet me vazhdueshmërinë e livrimit, si dhe cilësinë e gazit natyror që hyn në sistemin e transmetimit dhe ruajtjen e cilësisë së tij deri në daljen nga sistemi;

b) Të hartojë një metodologji për standardet dhe monitorimin e cilësisë së gazit natyror në pikat e hyrjes

dhe të daljes të sistemit të transmetimit, si pjesë e Kodit të Rrjetit të Transmetimit, të miratuar nga ERE; dhe

c) Të monitorojë në vijimësi cilësinë e gazit të transmetuar dhe të dorëzojë pranë ERE-s raporte periodike, në përputhje me metodologjinë e aprovuar.

2. I licencuari do të sigurojë dhe përmbushë cilësinë dhe nivelin e mirëmbajtjes së sistemit të transmetimit, siç përcaktohet nga ministria përgjegjëse për energjinë, si dhe kërkesat dhe standardet minimale për cilësinë e shërbimit, të përcaktuara nga ERE, si dhe të ofrojë shërbimet sipas specifikimeve të cilësisë dhe kushteve të vendosura në Kodin e Rrjetit të Transmetimit.

Neni 16

Konfidencialiteti i informacionit

1. I licencuari duhet të sigurojë që çdo informacion i marrë si rezultat i ushtrimit të aktivitetit të licencuar, nuk do t'i bëhet e ditur askujt, me përjashtim të rasteve:

a) Informacioni duhet të bëhet me dije gjatë kryerjes së aktivitetit të licencuar, në përputhje me kërkesat e transparencës të përcaktuara në nenin 48, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror" dhe pa ndikuar në detyrimet e të licencuarit për të ruajtur konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar;

b) Të licencuarit i kërkohej të deklarojë informacionin në përputhje me kushtet e licencës;

c) Është vendosur nga ERE;

d) Jepet pëlqimi paraprak me shkrim i personit me të cilin lidhet informacioni;

e) Me vendim të gjykatës dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi;

f) Në qoftë se informacioni është bërë publik.

2. I licencuari do të sigurojë që çdo biznes shoqërues nuk do të përdorë asnjë informacion të të licencuarit për të fituar një avantazh konkurrues të pajustificuar dhe do të sigurojë që nuk do të përhapë asnjë informacion të ndonjë person tjetër (përfshirë biznese të tjera të lidhura) që mund ta mundësojnë këtë person të arrijë përfitim tregtar të pajustificuar.

3. Çdo informacion me avantazh tregtar që i përket të licencuarit duhet të shpërndahet në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese dhe duhet të jetë i aksesueshëm lehtësisht dhe në mënyrë të barabartë nga të gjithë përdoruesit aktualë dhe të mundshëm të sistemit, si dhe palët e tjera të interesuara. Shpërndarja e informacionit me avantazh tregtar duhet të kryhet për të parandaluar trajtimin preferencial të përdoruesve individualë të sistemit ose të palëve të tjera të interesuara, në lidhje me fushën e veprimit, përmbajtjen dhe/ose formën e informacionit të shpërndarë dhe/ose kohën kur është shpërndarë.

4. I licencuari do të hartojë dhe do të paraqesë pranë ERE- s procedurat për të siguruar zbatimin e kësaj pike. I licencuari do të ndërmarrë çdo hap të nevojshëm për ta ruajtur informacionin konfidencial në posedim të të licencuarit dhe për t'i raportuar ERE-s në përputhje me obligimet e paraqitura në këtë nen. Politika e konfidencialitetit të të licencuarit mund të përshkruhet në programin e pajtueshmërisë, sipas kushteve të kësaj licence dhe/ose akteve të tjera nënligjore. Politika e konfidencialitetit të të licencuarit duhet të publikohet në faqen e internetit dhe të aksesohet nga çdo palë e interesuar.

5. Informacioni i dërguar ERE-s nga i licencuari do të konsiderohet publik me përjashtim të rasteve kur me kërkesë specifike të të licencuarit, ERE, me vendim, përcakton që ky informacion është i natyrës pronësore dhe nuk duhet të bëhet përhapja e tij në publik.

6. ERE ruan konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar të siguruar nga i licencuari, sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

PJESA E GJASHTË

Neni 17

Amendimet e licencës

Amendimi i kushteve të kësaj licence do të bëhet në përputhje me "Rregulloren për procedurat dhe

afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror” dhe nenit 28, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

Neni 18

Vendosja e masave administrative dhe heqja e licencës

1. Nëse i licencuari nuk përmbush kushtet e kësaj licence, ERE mund të aplikojë masa administrative, sipas nenit 106, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe “Rregullores mbi kushtet dhe procedurat e vendosjes së gjobave dhe masën konkrete për çdo shkelje”.

2. ERE mund të heqë licencën, në përputhje me nenin 27, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”.

3. Në qoftë se i licencuari ndryshon statusin e tij ligjor ose strukturën e kontrollit të interesave të aksionarëve pa autorizimin e ERE-s, bordi i ERE vendos shfuqizimin e vendimit të licencimit dhe licenca bëhet e pavlefshme. Subjekti pasues i të licencuarit duhet të aplikojë për një licencë të re, në përputhje me “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”.

Neni 19

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe e drejta e apelimit

1. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet të licencuarit dhe çdo përdoruesi të sistemit të transmetimit apo ndonjë personi tjetër që lidhet me aktivitetin e transmetimit ose kushtet e kësaj licence do të zgjidhet me mirëkuptim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Në rast se nuk arrihet zgjidhja e mosmarrëveshjes me mirëkuptim, atëherë bazuar në kërkesën e çdo pale që është pjesë e kësaj mosmarrëveshjeje, ERE nxjerr vendimin e saj në zbatim me nenin 98, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe “Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”.

3. I licencuari mund të apelojë vendimin e ERE-s në Gjykatën e Administrative Tiranë.

4. I licencuari ka detyrimin të zbatojë vendimin e ERE-s deri në nxjerrjen e një vendimi nga Gjykata kompetente mbi kërkesën dhe shqyrtimin e vendimit të ERE-s.

Aneksi përkatës

Të dhëna të përgjithshme mbi sistemin e transmetimit të presionit të lartë të gazit